

Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup





NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

RAPORT NGA DEBATET LOKALE:

ZHVILLIMET E REJA
GJEOPOLITIKE DHE
NDIKIMI I TYRE MBI
MAQEDONINË E VERIUT



RAPORT NGA DEBATET LOKALE:

ZHVILLIMET E REJA GJEOPOLITIKE DHE NDIKIMI I TYRE MBI MAQEDONINË E VERIUT

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

Autore:


Leandra Toska

Dizajni grafik:

Relativ


Maj 2024

Ky dokument bazohet në pikëpamjet e pjesëmarrësve dhe pjesëmarrseve në tre debatet lokale të mbajtura në periudhën shkurt - tetor 2023, të organizuara në kuadër të projektit «Nxitje e analizës së politikave dhe debatit publik 3.0», të cilin e realizon Instituti për politikë evropiane (EPI) - Shkup në bashkëpunim me Universitetin Stanford në ShBA, ndërsa financohet nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet dhe qëndrimet e Institutit për Politikë Evropiane dhe Fondacionit Kombëtar për Demokraci (NED) të ShBA-së.



PËRMBAJTJA

- 4 | Hyrje
- 6 | Cilat janë pikëpamjet e qytetarëve?
zhvillimet gjeopolitike dhe ndikimi i tyre mbi Maqedoninë e Veriut
- 7 | Rruga për në Bashkimin Evropian
- 8 | Prioritetet e brendshme politike dhe reformuese
- 9 | Maqedonia e Veriut në planin ndërkombëtar
- 10 | Përfundim



Hyrje

Zëri i qytetarëve duhet të jetë udhërrëfyes për përballimin e ndryshimeve dhe sfidave gjeopolitike në vend. Vendosija e vendit në rrugën euro-atlantike dhe marrja e sfidave si kryesimi me OSBE-në janë thelbësore për të garantuar perspektiva më të qëndrueshme.

Vitet e kaluara kanë sjellë një sërë ndryshimesh gjeopolitike, duke përfshirë zgjidhjen e mosmarrëveshjes rreth emrit me Greqinë, por edhe hapjen e sfidave të reja pas vetos bullgare.¹ Pavarësisht zgjidhjes së arritur,² implikimet e kësaj vetoje lanë pasoja me ndikim të madh për Maqedoninë e Veriut.³

Përveç kësaj, agresioni rus kundër Ukrainës dhe efektet ekonomike që ka shkaktuar në Maqedoninë e Veriut, në krye të pandemisë dhe efekteve ekonomike të kovid-19, ka pasur një ndikim serioz në jetën e qytetarëve.⁴ Kostot e rritura të jetesës, kriza energjetike dhe inflacioni⁵ shkaktuan presion shtesë, prandaj ishte thelbësore që vendi të përqendrohej në qeverisje më efektive dhe reforma ekonomike.

Përveç këtyre sfidave, kryesimi i Maqedonisë së Veriut me OSBE-në në vitin 2023⁶ hapi mundësinë që vendi të forcojë pozicionin e tij për të ruajtur stabilitetin në Ballkan, duke përforcuar aderimin e tij ndaj vlerave evropiane.⁷ Mbajtja e lidhjeve pozitive me aleatët dhe partnerët strategjikë është thelbësore në një kohë krizash të mëdha dhe sfidash rajonale.⁸

Për t'i trajtuar dhe diskutuar këto tema dhe çështje, si dhe për të siguruar që zëri i qytetarëve të dëgjohet nga vendimmarrësit, Instituti për politikë evropiane – Shkup organizoi tre ngjarje debatuuese lokale në Tetovë, Manastir dhe Shkup në periudhën mes shkurtit dhe tetorit të vitit 2023. Këto diskutime synonin të angazhonin qytetarët në debate gjithëpërfshirëse me vendimmarrësit dhe ekspertët përkatës, për të dëgjuar mendimet e tyre mbi temat kryesore dhe për të mundësuar ndërgjegjësim dhe përfshirje më të madhe të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

1 <https://www.aa.com.tr/en/europe/bulgaria-blocks-north-macedonias-eu-accession-talks/2047340>

2 <https://vlada.mk/node/29432>

3 <https://epi.org.mk/wp-content/uploads/reakcija-mozni-posledici-bugarija.pdf>



4 <https://www.rcc.int/pubs/161/balkan-barometer-2022--special-security-edition-impact-of-the-war-in-ukraine-on-the-western-balkans-public-and-business-opinion>

5 <https://novamakedonija.com.mk/pecateno-izdanie/makedonija-so-najvisoka-inflacija-vo-poslednite-25-godini>

6 <https://mfa.gov.mk/en/page/13/post/3239/severna-makedonija-na-chelo-na-najgolemata-svetska-regionalna-bezbednosna-organizacija-obse>

7 <https://novamakedonija.com.mk/pecateno-izdanie/zavrshena-e-dobra-rabota-no-se-propushtija-i-nekoi-mozhnosti/>

8 <https://mfa.gov.mk/en/page/26/post/2994/joint-statement-on-the-north-macedonia-us-strategic-dialogue>



Gjithsej 82 qytetarë, nga rajone të ndryshme, morën pjesë në këto ngjarje, ku kishin rastin të diskutojnë, me moderatorë dhe ekspertë në temën "Zhvillimet e reja gjeopolitike dhe ndikimi i tyre mbi Maqedoninë e Veriut". Përfundimet dhe rekomandimet nga këto diskutime do të shërbejnë si bazë për Anketën e katërt kombëtare debatuese, të cilën EPI do ta realizojë në vitin 2024, në bashkëpunim me Qendrën për Demokraci Deliberative pranë Universitetit Stanford në ShBA.

Ngjarjet debatuese lokale dhe Anketa kombëtare debatuese synojnë të krcin qytetarët në debate kuptimplota, duke u ofruar atyre një mundësi për tu angazhuar dhe për të formuar politika që ndikojnë në jetën e tyre.

Për të përcjellë debatet në mënyrë më autentike, raporti ruan një formë dhe rrëfim më të lirë.

Cilat janë pikëpamjet e qytetarëve? – zhvillimet gjeopolitike dhe ndikimi i tyre mbi Maqedoninë e Veriut

Dy vitet e fundit janë shënuar nga zhvillime të rëndësishme globale që kanë krijuar pasiguri të dukshme dhe kanë hapur shumë sfida për vendin. Duke marrë parasysh kontekstin politik në vend dhe sfidat e shumta, ishte shumë e rëndësishme të sigurohej hapësirë për dialogun që mungonte, me qëllim të analizimit dhe testimit të perceptimeve të qytetarëve në temën “Zhvillimet e reja gjeopolitike dhe ndikimi i tyre mbi Maqedoninë e Veriut”. Sesionet për diskutim ofruan një pamje gjithëpërfshirëse dhe të nuancuar të qëndrimeve të shoqërisë mbi sfidat komplekse gjeopolitike. Nga zhgënjimet me mospranimin në BE deri te shqetësimet në lidhje me krizën energjetike, qytetarët kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në formësimin e narrativës së rrugëtimit të vendit të tyre. Ndërlidhja e konflikteve globale, shqetësimeve të brendshme dhe partneriteteve strategjike theksoi kompleksitetin e peisazhit gjeopolitik të Maqedonisë së Veriut.

Si pyetje kryesore që u veçuan në këto diskutime, dhe që qytetarët u’a parashtruan ekspertëve, ishin marrëdhëniet me Bullgarinë dhe ndikimi i tyre në procesin e pranimit në BE, përfshirja e bullgarëve në Kushtetutë, parimet e BE-së në marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut në krahasim me vendet tjera, lufta kundër korrupsionit dhe përballja me të, si dhe rritja dhe arsytet për rritjen e euroskepticizmit.

Rruga për në Bashkimin Evropian

Pothuajse dy dekada pasi u bë kandidatë zyrtarë e Bashkimit Evropian (BE), rruga e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim mbetet e vështirë edhe pas zbatimit të gjerë të reformave të nevojshme. Nga ndryshimet komplekse kushtetuese deri në masa të përforcuara të antikorrupsionit, vendi ka pësuar transformime të rënda me shpresën se do të hyjë në BE.

Pjesëmarrësit pretenduan se vendi i ka plotësuar të gjitha kërkesat teknike me përpjekje të mëdha e madje edhe ndryshime të rrezikshme kushtetuese. Duke marrë parasysh që BE po përshpejton kandidaturat e Ukrainës, Moldavisë dhe Gjeorgjisë, qytetarët pyetën pse për vendin e tyre procesi i pranimit është më i vështirë, edhe pse vendi ka dëshmuar përparim të dukshëm. Megjithatë qytetarët konsiderojnë se ndryshimet kushtetuese për të përfshirë pakicën etnike bullgare në preambulën kushtetuese mund të jenë të pranueshme, ata gjithashtu theksuan se vendi duhet të ruajë dinjitetin e tij.

Qytetarët besojnë fuqimisht se Bashkimi Evropian duhet të ndërmarrë hapa konkretë në njohjen e përpjekjeve dhe përparimit të vendit, dhe se Maqedonia e Veriut duhet të bëhet anëtare e BE-së sa më shpejt të jetë e mundur, si alternativë e vetme për zgjidhjen e problemeve të shumta me të cilat përballlet vendi dhe rajoni.

Deklarata nga pjesëmarrësit:

“Ne duhet të bëjmë punën tonë dhe të kapim vagonin në trenin e fundit. Jo sepse është pjesë e politikës së jashtme, por sepse është e rëndësishme për qytetarët, në mënyrë që të kemi një cilësi më të mirë të jetës.”

“Rruga drejt BE-së është e vështirë dhe plot sakrifica, por qëllimi justifikon të gjitha vështirësitë.”

“Pavarësisht procesit të gjatë të pranimit, dëshira e qytetarëve për integrim mbetet e njëjtë.”

Prioritetet e brendshme politike dhe reformuese

Qytetarët gjithashtu paralajmëruan për shkeljen e sundimit të ligjit dhe demokracisë në Maqedoninë e Veriut. Ndërsa korrupsioni duket se po forcohet gjithnjë e më shumë në vitet e fundit, rikthimi i besimit të publikut në drejtësinë dhe institucionet shihet si jetike për t'i hapur rrugën prosperitetit. Qytetarët argumentuan se, në vend që vendi të mbështetet vetëm në burime të jashtme për të garantuar sigurinë, duhet në fakt t'i përshpejtojë reformat e brendshme duke trajtuar korrupsionin dhe duke përforcuar institucionet e sundimit të ligjit. Janë shprehur shqetësime se kanë një prapambetje në përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe siguruar pavarësinë e gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut, pasi polemikat mbi dënimet për ish-zyrtarë përforcuan perceptimet e shoqërisë se ekziston elitë politike e paprekshme që gëzon pandëshkueshmëri pavarësisht abuzimit të pushtetit. Ndryshimet e fundit në Kodin Penal konfirmuan frikën se kërcënohet integriteti i gjyqësorit.

Deklarata nga pjesëmarrësit:

“Ne duhet të përqendrohemi në reformat e brendshme, nuk ka nevojë të thellohem në faktin se kujdesi shëndetësor, institucionet publike nuk funksionojnë në nivel që është i kënaqshëm dhe mendoj se ky duhet të jetë fokusi ynë.”

“Elitat tona politike kanë treguar paaftësi për të përmirësuar standardin dhe për të zvogëluar korrupsionin, i cili duhet të bëhet, mbi të gjitha, për të mirën e popullit.”

“Korrupsioni është i rrënjosur në shoqërinë tonë dhe shteti nuk ka aftësinë e brendshme për t'u marrë me të, dhe nga këtu vjen shpresa se BE dhe Shtetet e Bashkuara do të na ndihmojnë me këto probleme.”

Maqedonia e Veriut në planin ndërkombëtar

Një aspekt kritik i vënë në pah përgjatë diskutimeve ishte ndërthurja e krizave energjetike me tensionet gjeopolitike globale. Pjesëmarrësit theksuan ndërlikimet që rrjedhin nga roli i Rusisë si prodhuese kryesore e energjisë dhe theksuan nevojën për të ndërtuar infrastrukturë më të pastër të brendshme, për të rritur kapacitetet lokale dhe diversifikimin e partnerëve të tregtisë dhe energjisë jashtë Rusisë.

Që kur Maqedonia e Veriut mori kryesimin e OSBE-së në vitin 2023, qytetarët kanë diskutuar se kjo situatë paraqet një mundësi për të forcuar kredencialet e leadershipit të vendit në promovimin e stabilitetit dhe parimeve të bashkëpunimit, në një kohë kur siguria evropiane po kalon një periudhë të trazuar. Qytetarët i bënë thirrje Maqedonisë së Veriut të orientojë politikën e saj strategjike drejt forcimit të aleancave me fuqitë e mëdha që mund të garantojnë siguri afatgjate në rajon.

Në këtë drejtim, partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara është vënë në dukje si një element kyç. Së bashku me qytetarët, ne eksploruam përfitimet e mundshme të bashkëpunimit më të afërt me Shtetet e Bashkuara, duke përfshirë partneritetet ekonomike dhe përparimet teknologjike. Shumë qytetarë besojnë dhe pretendojnë se Shtetet e Bashkuara janë partneri i vërtetë dhe më i besueshëm i Maqedonisë së Veriut.

Deklarata nga pjesëmarrësit:


“Ne nuk mund t’i zgjidhim çështjet e sigurisë vetë, duhet të bashkëpunojmë me vendet e tjera dhe me aleatët tanë.”

“Mbrotjtja më e mirë kundër rreziqeve nga jashtë vjen nëse shteti është demokratik dhe nëse respekton të drejtat e njeriut.”


“Kur vendet bashkohen me BE-në, rritja ekonomike tregohet që në vitin e parë dhe kjo është shumë e rëndësishme për vendin tonë.”

PËRFUNDIM

Diskutimet me qytetarët u organizuan në përputhje me një metodologji të zhvilluar, e cila përdoret nga EPI për disa cikle radhazi. 82 qytetarë nga qytete dhe rajone të ndryshme të vendit si: rajoni i Pollogut (përfshirë qytetet e Tetovës dhe Gostivarit), rajoni i Pellagonisë (përfshirë qytetet e Manastirit dhe Prilepit) dhe rajoni i Shkupit. Diskutimet debatuuese lokale u organizuan në një format ku pjesëmarrësit në pjesën e parë të ngjarjes patën mundësinë të diskutojnë me njëri-tjetrin, si dhe me moderatorin e ngjarjes. Për të inkurajuar mendimin e qytetarëve ose për të sqaruar çështje të caktuara që u ngritën gjatë diskutimeve, secila prej tre ngjarjeve ka përfshirë një sesion të veçantë për diskutim me ekspert(e) të fushës. Sipas dilemave dhe pyetjeve të parashtruara nga pjesëmarrësit, ekspertët i'u përgjigjën pyetjeve dhe diskutuan me ta.



Në periudhën nga shkurti deri në tetor të vitit 2023, Instituti për politikë evropiane - Shkup organizoi tre debate lokale me 82 qytetarë nga qytete dhe rajone të ndryshme të vendit:



Qëllimi i debateve ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes qytetare, duke përdorur metodën e anketës debatuuese dhe konceptet e debatit demokratik dhe debateve qytetare.

Diskutimet dhe rekomandimet që dalin nga këto debate do të shërbejnë si përgatitje për Anketën e katërt kombëtare debatuuese, të cilën EPI do ta realizojë në përputhje me metodologjinë dhe në bashkëpunim me Universitetin Stanford nga ShBA. EPI e realizon anketën debatuuese që nga viti 2017, si organizata e parë në rajon. Anketa është një metodë e konsultimit publik që u jep pjesëmarrësve mundësinë për të ndarë pikëpamjet e tyre në një mjedis të hapur dhe të sigurtë. Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë argumentet pro dhe kundër çështjeve të ndryshme. Kjo metodë do të zbulojë se çfarë do të mendonin pjesëmarrësit nëse do të informoheshin për temat e dhëna.



Nga ngjarjet debatuese lokale mund të shihet se përdherisa shoqëria kalon nëpër këto çështje dhe sfida, njohuritë nga këto diskutime ofrojnë perspektiva të vlefshme për politikëbërësit, duke theksuar nevojën për një qasje proaktive, transparente dhe gjithëpërfshirëse për të trajtuar dinamikat e shumëanshme që formësojnë të ardhmen e kombit.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore që dolën nga diskutimet, të cilat qytetarët i konsiderojnë të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së vendit:

1. Rritja e përpjekjeve për të çuar përpara procesin e anëtarësimit në BE me diplomaci aktive, duke u fokusuar në reformat e brendshme.
2. Përmirësimi i kapaciteteve të sigurisë përmes bashkëpunimit me OSBE-në dhe aleatët e tjerë, me fokus dialogun, trajtimin e sfidave të brendshme dhe mbështetjen e stabilitetit në rajon.
3. Zhvillim dhe zbatim i strategjive për zvogëlimin e varësisë nga burimet e energjisë, zhvillimi i infrastrukturës së brendshme dhe prezantimi i masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.
4. Menaxhim dhe pranim më efektiv i reformave ekonomike për të stabilizuar ekonominë.
5. Nevojiten hapa konkretë nga BE për procesin e anëtarësimit dhe njohjen e progresit të vendit, në mënyrë që të ruhet mbështetja për integrimin evropian.
6. Komunikim dhe informim i përforcuar i shoqërisë më të gjerë lidhur me marrëveshjet dhe hapat kryesorë strategjikë të vendit.

